



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 20.4.2023

Nr: 393

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHKARKIM TË SEKRETARIT TË KZAZ NR. 92, BASHKIA KONISPOL, SEKRETARIT DHE ANËTARIT
TË KZAZ NR. 26, BASHKIA VORË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË
DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenit 32, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 10 të Vendimit nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

V Ë R E N

Në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve, janë depozituar dy procesverbale të mbajtura nga KZAZ nr. 26, Bashkia Vorë, dhe KZAZ nr. 92, Bashkia Konispol, në të cilat referohet si më poshtë:

- KZAZ nr. 26, Bashkia Vorë, raporton mungesën, në mënyrë të vazhdueshme, të anëtarit dhe sekretarit, të propozuar nga Partia Demokratike. Në vijim të punës së KZAZ-së, mungesa e sekretarit dhe njërit prej anëtarëve, përbën shqetësim në mbarëvajtjen e procesit dhe ecurinë e punës.
- KZAZ nr. 92, Bashkia Konispol, sikundër shqetësimi i KZAZ-së nr. 26, raporton se sekretari i emëruar, i propozuar nga Partia Demokratike, nuk është paraqitur në detyrë, në më shumë se 4 mbledhje të zhvilluara.

Data: 20.4.2023 Nr: 393
Ora: 11:00



“Për shkarkim të sekretarit të KZAZ nr. 92, Bashkia Konispol, sekretarit dhe anëtarit të KZAZ nr. 26, Bashkia Vorë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të dates 14 maj 2023”

Gjithashtu, të dyja KZAZ-të, shprehen se anëtari dhe sekretarët përkatës, kanë depozituar dorëheqjet në KZAZ-të përkatëse, duke e konsideruar nga ana e tyre, të mirëqënë, mosparaqitjen në detyrë, pas dhënies së dorëheqjes.

Vendimi nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor”, përcakton:

- në nenin 12, pika 1, anëtari apo sekretari i KZAZ-së, i shkarkuar, i liruar apo dorëhequr nga detyra, nuk mund të largohet nga KZAZ-ja, pa dorëzuar detyrën tek zëvendësuesi i tij.
- në nenin 12, pika 4, Komisioneri njofton subjektin përkatës të dorëzojë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, brenda tre ditëve, gjatë periudhës zgjedhore, dhe brenda tre orëve, në ditën e zgjedhjeve, propozimin dhe dokumentacionin për vendin vakant të anëtarit apo sekretarit të KZAZ-së.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka njoftuar në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe Udhëzimit të Komisionit Rregullator, Partinë Demokratike për vakancat e krijuara nga dorëheqjet e anëtarëve dhe sekretarëve në këto KZAZ. Partia Demokratike, brenda këtij afati, nuk ka depozituar asnjë kërkesë për zëvendësimin e tyre.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 5, të Kodit Zgjedhor, nëse partitë politike të shumicës parlamentare dhe të opozitës parlamentare, që kanë të drejtë të paraqesin kandidatura për KZAZ, nuk e ushtrojnë këtë të drejtë në afatin e përcaktuar, kjo e drejtë u kalon automatikisht partive që vijnë në radhë me numër vendesh në Kuvend pas të parave, brenda grupimit përkatës. Sipas përcaktimeve të Kodit, Partisë së Lirisë, i lind e drejta të paraqesë propozimet për vakancat e krijuara.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenet 29, 30, 31, dhe 32, paragrafi 2, shkronja “d”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Shkarkimin nga detyra të 2 (dy) sekretarëve dhe anëtarit, të propozuar nga Partia Demokratike, si vijon:
 - sekretari i KZAZ nr. 26, z. Ardian Xhemal Xhakoni, Bashkia Vorë,
 - anëtari i KZAZ nr. 26, z. Denis Asllan Hasrama, Bashkia Vorë,
 - sekretari i KZAZ nr. 92, z. Hqmet Adem Bello, Bashkia Konispol.
2. Partia e Lirisë, të dorëzojë propozimet, për plotësim të vakancave, jo më vonë se data 23.4.2023.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i njoftohet KZAZ-ve përkatëse.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI